

KOSOVO



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

Prishtinë, 26.04.2022

Komiteti Olimpik i Kosovës ka statusin e personit juridik, është e regjistruar si organizatë joqeveritare pranë MAP si dhe i takon Lëvizjes Olimpikë duke u angazhuar që të respektojë dispozitat e Kartës Olimpikë, andaj si e tillë bashkëpunon me organet publike të Republikës së Kosovës për zhvillimin e sportit, lidh kontrata të ndryshme, punëson si dhe angazhon persona juridik dhe fizik të cilat janë të domosdoshëm për realizimin dhe arritjen e qëllimeve të promovimit të Lëvizjes Olimpikë, etikës në sport, qeverisjes së mirë si dhe zhvillimit të sportit në përgjithësi.

Bordi Ekzekutiv i KOK në mënyrë që të arrijë qëllimet dhe misionin e tij janë pajtuar që të bashkëpunojnë ngushtë me organet publike në Republikën e Kosovës sic është MKRS, respektivisht KOK do të bashkëpunojnë në procesin e hartimit të Koncept Dokumentit për Sport me MKRS, për cka nevojitet ndihma e Ekspertëve Ligjor vendor, andaj KOK shpall këtë:

Thirrje publike për aplikim të kompanive, bizneseve individuale apo ekspertëve individual në fushën e “Hartimit të Koncept Dokumentit për Sport”

Komiteti Olimpik i Kosovës bën thirrje publike kompanive, bizneseve individuale apo ekspertëve individual për hartimin e Koncept Dokumentit në fushën e Sportit, në përputhje me kriteret e mëposhtme.

Kompania, biznesi individual apo eksperti individual i cili do të kontraktohet për kryerjen e këtij shërbimi do të vlerësohet nga cilësia, cmimi më i volitshëm si dhe përvoja në realizimin dhe projektimin e dokumenteve të tilla (sidomos në fushën e sportit). Bazuar në këtë, detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të kontraktuesit, do të jenë si në vijim:

- a. Udhëheqja, koordinimi dhe hartimi i Koncept Dokumentit për Sport;
- b. Përgatitja e planit të punës me detyra dhe përgjegjësitë e tjera si dhe afatet kohore për secilën fazë të hartimit të Koncept Dokumentit;
- c. Përfshirja në hartimin e pjesëve dhe mjeteve të Koncept Dokumentit të cilat kërkohen të zhvillohen sipas Udhëzuesit dhe Doracakut për hartimin e Koncept Dokumenteve si dhe përgatitja e analizave përkatëse;
- d. Ofrimin e ekspertizës në definimin e gjendjes ekzistuese dhe zhvillimin e opsioneve;
- e. Matjen e ndikimit të opsioneve si dhe ofrimin e mbështetjes së realizimit të procesit të konsultimeve prapake dhe konsultimeve me publikun;
- f. Të gjitha aktivitetet do të zhvillohen në koordinim të ngushtë në mes të ekspertëve ndërkombëtarë dhe atij vendor duke përfshirë koordinimin e ngushtë me KOK dhe MKRS-në me qëllim që Koncept Dokumenti të miratohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe të krijojë një bazë të shëndosh për rishikimin e kornizës ligjore në fuqi në fushën e Sportit.
- g. Sipas kërkesës së KOK dhe MKRS-së kryen edhe punë të tjera që ndërlidhen me vendin e punës;

h. Informon rregullisht për punët e kryera pranë KOK dhe MKRS;

Kohëzgjatja e projektit:

- Fillon më 1 Qershor 2022;
- Dita e fundit e dorëzimit të projektit final 23 dhjetor 2022;
- Përfundimi i projektit 31 dhjetor 2022, respektivisht 7 muaj;

Kjo thirrje publike do të jetë e hapur për 10 ditë, respektivisht afati për aplikim është deri më 16 Maj 2022;

Komiteti Olimpik i Kosovës do të shpall emrin e Kontraktuesit potencial të përzgjedhur për bashkëpunim dhe hyrje në marrëveshje publike, dy (2) ditë pas përfundimit të afatit për aplikim.

Kompania, biznesi individual apo eksperti individual i cili ka aplikuar në këtë thirrje ka mundësi që të ankohet brenda afatit prej 10 ditëve që nga marrja e përgjigjes nga KOK.